

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi kontestet e procedurës ekonomike - ankesa e refuzuar - ankesa e palejueshme - aktgjykimi i formës së prerë - neni 348 (1) LPK]

I padituri paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë duke mbajtur qëndrimin se Gjykata kishte zbatuar të drejtën materiale gabimisht.

Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata Ekonomike e Qarkut kishte vepruar drejtë kur kishte gjetur se ankesa e të paditurit ishte e pabazuar duke konsideruar se i padituri kishte paraqitur ankesë kundër aktvendimit të formës së prerë të Gjykatës Supreme.

Gjykata Supreme ka vendosur se ankesat e paraqitura kundër aktvendimeve të Gjykatës Supreme e cila kishte vendosur përkitazi me ankesën dhe kishte vërtetuar aktvendimin e Gjykatës së shkallës së parë, nuk lejohen siç parashihet me nenin 348 (1) të LPK-së. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e të paditurit është e pabazuar.

Ae.nr.10/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Meleqe Behxheti, kryetare, Shahdane Agani dhe gjyqtari porot Ejup Neziri, anëtarë, në çështjen juridike të paditëses B. e R. e K. "brk" Sh.a.p.k Prishtinë, kundër të paditurës N.P.SH "EURODARD" Prishtinë, për pagesën e borxhit, përkitazi me ankesën e së paditurës, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë C.nr.182/2003 datë 10.02.2005, në seancën e mbajtur më 26.04.2005, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e së paditurës dhe vërtetohet aktvendimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut Prishtinë C.nr.182/2003 datë 10.02.2005.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut Prishtinë është hedhur poshtë si e palejueshme ankesa e së paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut Prishtinë, C.nr.182/2003 datë 12.01.2004.

Kundër këtij aktvendimi e paditura ka paraqitur ankesë, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që aktvendimi i goditur të priset dhe lënda t'i kthehet Gjykatës së Shkallës së Parë në rivendosje.

Pas shqyrtimit të aktvendimit të goditur sipas nenit 365 lidhur me nenin 381 të LPK, Gjykata Supreme e Kosovës gjeti se ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës dhe aktvendimit të goditur del se Gjykata Supreme e Kosovës, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, me aktgjykimin Ac.nr.23/2004 datë 27.05.2004, e ka refuzuar ankesën dhe aktgjykimin e Gjykatës së Shkallës së Parë e ka vërtetuar. E paditura ka paraqitur ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, duke kërkuar që borxhi sipas padisë së paditëses të riprogramohet në afatin prej 24 muajsh duke filluar që nga data 01.06.2005, gjer më 01.06.2007. Gjykata Ekonomike e Qarkut Prishtinë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se ankesa nuk është e lejueshme, meqë aktgjykimi ka vërtetuar, ashtu që ankesa nuk është e lejueshme kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, Gjykata e Shkallës së Parë ka vepruar drejt kur ka gjetur se ankesa e së paditurës është e palejueshme dhe në aktvendimin e vet ajo ka dhënë arsye të mjaftueshme të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, me të cilin është vendosur lidhur me ankesën dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë, ankesa nuk është e lejueshme, ngase sipas nenit 348 par.1 të LPK, palët mund të paraqesin ankesë kundër vendimit të dhënë në shkallë të parë. Ngase aktgjykimi me të cilin është vendosur lidhur me ankesën është vendimi i shkallës së dytë dhe jo vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë, as sipas kësaj dispozite, as sipas ndonjë dispozite tjetër juridike, ankesa kundër aktgjykimit të Gjykatës së Shkallës së Dytë nuk është e lejueshme, prandaj, sipas vlerësimit edhe të kësaj Gjykate, Gjykata e Shkallës së Parë ka vepruar drejtë kur ka gjetur se ankesa nuk është e lejueshme dhe, si të tillë, e ka hedhur poshtë.

Në bazë të asaj që u tha dhe me zbatimin e nenit 380 pika 2 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Ae.nr.10/2005, datë 26.04.2005

Kryetare e kolegjit,
Meleqe Behxheti

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi kontestet ekonomike - ankesa e refuzuar - parashkrimi i veprës - neni 378(1) pika 3 ligji mbi detyrimet]

Paditësi paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut duke mbajtur qëndrimin se Gjykata kishte shkelur dizpozitat e aplikueshme të procedurës kontestimore, kishte vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë dhe kishte zbatuar gabimisht të drejtën materiale.

Paditësi kërkoi nga i padituri që të paguajë detyrimin në emër të shërbimeve të ofruar nga rrjeti publik sistemit të telekomunikacionit, të cilën i padituri e kishte shfrytëzuar. I padituri kishte kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit dhe kishte kontestuar vlerën e borxhit duke theksuar se borxhi ishte parashkruar.

Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata ekonomike kishte bërë vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike dhe se kishte zbatuar drejtë të drejtën materiale kur gjeti kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar në bazë të të parashkrimit të borxhit, siç parashikohet me nenin 378 (1) pika 3 e ligjit mbi marrëdhëniet detyrimore. Gjykata Supreme ka vendosur se borxhi i nënshtrohet parashkrimit pas një viti. Në rastin në vijim kërkesëpadia e paditësit përkitazi me shfrytëzimin e shërbimeve telefonike i nënshtrohet parashkrimit pas një viti. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e paditësit është e pabazë.

Ae.nr.14/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji për konteste ekonomike i përbërë nga gjyqtarët: Shahdane Agani, kryetare, Meleqe Behxheti dhe gjyqtari porot Ejup Neziri, anëtarë, në kontestin e paditëses P. dhe T. i K., në Prishtinë, kundër të paditurës "Elan" në Prizren, për borxh, në shumë prej 10.287,78 €, përkitazi me ankesën e paditëses paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut Prishtinë C.nr.202/2004 datë 23.11.2004, në seancën e mbajtur më 26.04.2005, mori këtë

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditëses dhe vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut Prishtinë C.nr.202/2004 datë 23.11.2004.

A r s y e t i m i

Me pjesën I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut Prishtinë, C.nr.202/2004 datë 23.11.2004, është ç'fuqizuar aktvendimi mbi lejimin e përmbarimit, E.nr.221/2004 datë 22.10.2004. me pjesën II të dispozitivit, është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses që të detyrohet e paditura t'ia paguajë asaj në emër të borxhit shumë prej 10.287,78 € me kamat sipas normës vjetore në lartësi prej 3% konform me mjetet e deponuara në Bankën Komerciale pa destinim të caktuar në afat mbi një vit, duke filluar prej 1.09.2002 deri në pagesën definitive, në afatin prej 8 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm. Me pjesën III të dispozitivit është vendosur që secila palë t'i heqë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

Kundër këtij aktgjykimi paditësja me kohë ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i goditur të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditëses të pranohet në tërësi si e bazuar ose ai të priset dhe lënda t'i kthehet Gjykatës së Shkallës së Parë për rigjykim.

Pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 365 të LPK, Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se paditësja me padi kërkon që e paditura të detyrohet që asaj t'ia paguajë në emër dhënies së shërbimeve të rrjetit publik të sistemit të telekomunikacionit borxhin në vlerë prej 10.287,78 €, për periudhën shtator 2001 deri më korrik 2003. E paditura në kundërshtim ka kontestuar borxhin, duke cekur parashkrimin e borxhit.

Gjykata e Shkallës së Parë, ka vërtetuar se paditësja detyrimin e vet për periudhën kontestuese ndaj të paditurës e ka kryer rregullisht, ndërsa e paditura shumë e borxhit të lartëshënuar nuk ia ka paguar paditëses, dhe se borxhi është parashkruar, meqë ky kërkohet për periudhën shtator 2001 deri më korrik 2003, ngase padia është paraqitur më 21.10.2004, pas afatit prej një viti, parashkruar nga neni 378 par. 1 të Ligjit të Marrëdhënieve Detyrimore (LMD).

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se Gjykata e Shkallës së Parë drejt dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, në bazë të së cilës drejt e ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesë-padia është e pabazuar për arsytet e parashkrimit të borxhit. Në arsyetimin e aktgjykimit ajo ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë. Aktgjykimi i goditur nuk përmban shkelje thelbësore, për të cilat kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Për faktin se borxhi kërkohet në emër të dhënies së shërbimeve të rrjetit

publik të sistemit të telekomunikacionit, për periudhën shtator 2001 deri më korrik 2003, Gjykata e Shkallës së Parë drejt e ka zbatuar të drejtën materiale kur ka gjetur se, sipas nenit 378 par.1 pika 3 të Ligjit të Marrëdhënieve Detyrimore, borxhi është parashkruar.

Me nenin 378 par.1 pika 3 të LMD parashikohet që kërkesa e Postës, telegrafit dhe telefonit për përdorimin e telefonit, si dhe kërkesat e tjera të tyre, që arkëtohen në afatet tre mujore ose afate më të shkurtra, parashkruhen në afat prej një viti, që do të thotë se sipas nenit të lartpërmendur borxhi është parashkruar.

Në bazë të asaj që u tha dhe me zbatimin e nenit 368 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
Ae.nr.14/2005, datë 26.04.2005

Kryetare e kolegjit,
Shahdane Agani

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi kontestet ekonomike - ankesa e refuzuar - aktgjykimi në mungesë neni 332 (1) LPK]

I padituri M.F.S "Krokodili" në Ferizaj paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut, duke mbajtur qëndrimin se Gjykata kishte vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë gjendjen faktike dhe kishte zbatuar gabimisht të drejtën materiale.

Gjykata Ekonomike e Qarkut mori aktgjykimin në mungesë kundër M.F.S "Krokodili" në Ferizaj dhe urdhëroi atë të paguajë borxhin "Bankës së Re e Kosovës" brenda 8 ditëve.

Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata kishte bërë vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike dhe kishte zbatuar drejtë të drejtën materiale gjatë marrjes së aktgjykimit në mungesë dhe se kushtet ligjore janë plotësuar duke konsideruar se i padituri është thirrur rregullisht siç parashihet me nenin 332 të LPK-së. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e palës së paditur është e pabazë.

Ae.nr.20/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji për konteste ekonomike i përbërë nga gjyqtarët: Shahdane Agani, kryetare, Meleqe Behxheti dhe gjyqtari porot Ejup Neziri, anëtarë, në kontestin e paditëses B. e R. e K. (BRK) në Prishtinë, kundër të paditurës M.F.S. "Krokodili" në Ferizaj, të cilën e përfaqëson N. A., pronari i paditurës, për kthimin e kredisë, vlera e kontestit 6.000 €, përkitazi me ankesën e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut Prishtinë, C.nr.220/2004 datë 8.02.2005, në seancën e mbajtur më 26.04.2005, mori këtë

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut Prishtinë, C.nr.220/2004 datë 8.02.2005.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin për shkak të mungesës të Gjykatës Ekonomike të Qarkut Prishtinë, C.nr.220/2004 datë 8.02.2005, është detyruar e paditura t'i paguajë paditëses në emër të borxhit - shumën prej 6.000 €, në emër të kamatës

së kontraktuar në shumë prej 93 €, si dhe kamat-vonesën prej 0,08% në ditë duke llogaritur nga data 22.08.2004 deri në pagesën definitive dhe shumën prej 152,50 € në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, të gjitha këto në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, në kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.

E paditura ka paraqitur me kohë ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ai të priset dhe lënda t'i kthehet të njëjtës Gjykatë për rigjykim.

Pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 365 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se në bazë të kontratës së kredisë nr.81/2004 datë 22.07.2004, e paditura ka marrë kredi nga paditësja në shumë prej 6.000 €, të cilën është detyruar t'ia kthejë asaj në afat prej 15 ditësh. Paditësja në tërësi e ka përmbushur detyrimin e vet nga kontrata e kredisë, ndërsa e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin e vet.

Sipas dispozitës së nenit 332 të LPK, parashikohet se kur i padituri nuk vjen në seancën përgatitore deri në përfundimin e saj, ose në seancën e parë për në seancën kryesore po qe se seanca kryesore nuk është mbajtur, apo në qoftë se vjen në këto seanca por nuk dëshiron të hyj në shqyrtime ose largohet nga seanca e nuk e kundërshton kërkesëpadinë, do të nxirret aktgjykimi, me të cilin aprovohet kërkesëpadia (aktgjykimi për shkak të mungesës), po qe se janë plotësuar këto kushte: në qoftë se i padituri është thirrur rregullisht; në qoftë se paditësi propozon nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mungesës; në qoftë se i padituri nuk e ka kontestuar me parashtrësë kërkesë-padinë; në qoftë se bazueshmëria e kërkesëpadiës rezulton nga faktet e theksuara në padi; në qoftë se faktet në të cilat bazohet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka paraqitur vetë paditësi ose me faktet e njohura për të gjithë; në qoftë se nuk ekzistojnë rrethana të njohura për të gjitha nga të cilat rezulton se të paditurin e kanë penguar arsyet e justifikuar për të ardhur në seancë.

Meqë në rastin konkret janë plotësuar kushtet e parapara nga paragrafi 1 i këtij neni, Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se Gjykata e Shkallës së Parë drejt ka vendosur kur ka marrë aktgjykimin për shkak të mungesës.

Gjykata Supreme e Kosovës i ka vlerësuar si të pabazuara thëniet ankimore të paditurës se, siç është cekur në ankesë, aktgjykimi i goditur është marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, duke cekur se: "Unë këtë shumë të hollash e pata marrë nga paditësja për nevojat e ndërmarrjes sime dhe nuk munda ta kthej në afatin e paraparë, e për momentin edhe nuk kam

mundësi ta bëj një gjë të tillë".

Sipas dispozitës së nenit 1065 të LMD, me kontratën e kredisë banka detyrohet që shfrytëzuesit të kredisë t'i vë në disponim shumën e kontraktuar të mjeteve në të holla, në kohën e caktuar ose të pacaktuar, për ndonjë destinim të caktuar ose pa destinim të caktuar, ndërsa shfrytëzuesi i kërkesës detyrohet që bankës t'ia paguajë kamatën e kontraktuar dhe shumën e marrë të të hollave t'ia kthejë në kohën dhe mënyrën e përcaktuar me kontratë. Për faktin se e paditura nuk e ka përmbushur në tërësi detyrimin e vet sipas një kontrate të tillë, paditësja, në pajtim të dispozitës së nenit 262 të LMD, është e autorizuar që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit të kontraktuar.

Në bazë të asaj që u tha dhe me zbatimin e nenit 368 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
Ae.nr.20/2005, datë 26.04.2005

Kryetare e kolegjit,
Shahdane Agani

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi kontestet ekonomike - aktvendimi i prishur - ankesa e refuzuar - jurisdikcioni absolut i Gjykatës neni 354(2) pika 3/ neni 16(2) LPK - neni 14 LPP]

Kreditori NSHIMB "Kualiteti" paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë.

Kreditori me propozim për ekzekutimin e aktvendimit kërkon nga debitori që të paguajë borxhin. Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë refuzoi propozimin e kreditorit për të lejuar ekzekutimin e aktvendimit kundër debitorit Posti Ushtarak i Armatës Jugosllave në Leskovc.

Gjykata Supreme ka vendosur se aktvendimi i Gjykatës është në kundërshtim me dispozitat në fuqi të procedurës kontestimore siç parashihet me nenin 354 (2), pika 3 në lidhje me nenin 16 (2) të LPK-së dhe nenin 14 LPP. Gjykata Supreme gjeti se shkelja e procedurës kontestimore si e tillë buron nga faktet se propozimi për të lejuar ekzekutimin e aktvendimit kundër debitorit nuk bie as në kuadër të jurisdikcionit të Gjykatave të rregullta të Kosovës dhe as të ndonjë Gjykate tjetër me kompetencë të posaçme duke konsideruar se debitori nuk kishte as zyre përfaqësuese dhe as selinë e vet në territorin e Kosovës siç parashikohet me nenin 55 të Ligjit për Zgjidhjen e Konfliktëve me Jurisdikcionin e Huaj. Gjykata Supreme ka vendosur se nëse gjatë procedurës për zgjidhjen e konfliktit asnjë Gjykatë e themeluar me ligj nuk është kompetente, atëherë Gjykata hedh poshtë kërkesëpadinë siç parashihet me nenin 16(2) të LPK-së.

Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e kreditorit është e pabazë dhe prishi aktvendimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut dhe hodhi poshtë kërkesëpadinë.

Ae.nr.29/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji për konteste ekonomike i përbërë nga gjyqtarët: Shahdane Agani, kryetare, Meleqe Behxheti, Osman Tmava, anëtarë, në kontestin e kreditorit NSHIMB "Kualiteti" në Gjilan, kundër debitorit AJ Posta Ushtarak 5399 Leskovec, për borxh në vlerë prej 416.310,40 dinarë, sipas ankesës së kreditorit, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut Prishtinë, E.nr.63/2004 datë 21.04.2005, në seancën e mbajtur më 25.05.2005, mori këtë:

A K T V E N D I M

Prishtë aktvendimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut Prishtinë, E.nr.63/2004 datë 21.04.2005, hidhet poshtë padia.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut Prishtinë E.nr.63/2004 datë 21.04.2005, është refuzuar propozimi i kreditorit për lejimin e përmbarimit kundër debitorit AJ Posta Ushtarak 5399 Leskovec.

Kundër këtij aktvendimi kreditori me kohë ka paraqitur ankesë me propozim që aktvendimi i goditur të prishet dhe lënda t'i kthehet Gjykatës së Shkallës së Parë për rigjykim.

Pas shqyrtimit të aktvendimit të goditur sipas neni 365 par.2 lidhur me nenin 381 dhe 369 par.2 të LPK, Gjykata Supreme e prishi aktvendimin dhe e hodhi poshtë padinë.

Nga shkresat e lëndës del se kreditori me propozim për përmbarim kërkon që debitori të detyrohet që atij në emër të borxhit të paguajë shumën prej 416.310,40 dinarë.

Gjykata e Shkallës së Parë ka gjetur se debitori AJ Posta Ushtarak 5300 Leskovec sipas neni 21 të Ligjit të Procedurës Përmbaruese (LPP), nuk është person juridik që ushtron veprimtarinë ekonomike, prandaj ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se aktvendimi i goditur është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore parashikuar nga neni 354 par.2 pika 3 lidhur me nenin 16 par.2 të LPK dhe nenin 14 të Ligjit të Procedurës Përmbaruese (LPP), për të cilën kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare. Shkelje e tillë e procedurës kontestimore është e natyrës absolute për shkak të së cilës doemos duhet të prishet aktvendimi i goditur dhe të hidhet poshtë padia. Shkelja e tillë e procedurës kontestimore qëndron në faktet se propozimi për lejimin e ekzekutimit kundër debitorit AJ Posta Ushtarak 5300 Leskovec nuk është në kompetencë të Gjykatave të rregullta të Kosovës e as në kompetencë të asnjë gjykate të veçantë.

Ligji i Procedurës Kontestimore ka parashikuar se Gjykata gjatë tërë procedurës kujdeset sipas detyrës zyrtare se a është zgjidhja e kontestit në kompetencë gjyqësore. Kur gjykata gjatë procedurës konstaton se për zgjidhjen e kontestit nuk është kompetente asnjë Gjykatë e themeluar me ligj do ta hedhë padinë (neni 16 par.2 të LPK).

Me nenin 14 të Ligjit të Procedurës Përmbarese parashikohet se në procedurën e përmbaremit dhe të sigurimit zbatohen analogjikisht dispozitat e Ligjit të Procedurës Kontestimore, nëse me këtë Ligj ose me dispozita të tjera federative nuk është përcaktuar ndryshe.

Me nenin 46 par.1 dhe 2 të Ligjit për Zgjidhjen e Konfliktit të ligjeve me dispozitat e vendeve të tjera në marrëdhënie të caktuara parashikohet se ekziston kompetenca e RSFJ, nëse i padituri ka vendbanim, përkatësisht selinë, në RSFJ. Nëse i padituri nuk e ka vendbanimin në RSFJ dhe as në ndonjë shtet tjetër, kompetenca e Gjykatës së RSFJ ekziston kur i padituri është me vendqëndrim në RSFJ.

Me nenin 55 të Ligjit për Zgjidhjen e Konfliktit të ligjeve me dispozitat e vendeve të tjera në marrëdhënie të caktuara parashikohet se në kontestet kundër personit fizik apo personit juridik që ka selinë në botën e jashtme, për detyrimet që kanë lindur në RSFJ ose të cilat duhet të kryhen në territorin e RSFJ, ekziston kompetenca e Gjykatës së RSFJ nëse ky person ka në territorin e RSFJ përfaqësinë e vet ose kur në RSFJ ndodhet selia e organizatës së punës së bashkuar, së cilës i është besuar ushtrimi i punëve të tij. Në rastin konkret debitori nuk e ka as përfaqësinë e as selinë në territorin e Kosovës.

Kompetenca absolute - juridiksioni i Gjykatës është prezumimi themelor procedural për dhënien e mbrojtjes gjyqësore. Rrethana që për zgjidhjen e çështjes konkrete juridike nuk është kompetente asnjë Gjykatë e rregullt e as ndonjë Gjykatë tjetër e veçantë në Kosovë, del se aktvendimi është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe dispozitave të procedurës përmbarese, e cila si pasojë ka prishjen e aktvendimit.

Në bazë të asaj që u tha e me zbatimin e nenit 369 par.2 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË
Ae.nr.29/2005, datë 25.05.2005

Kryetare e kolegjit,
Shahdane Agani

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi kontestet ekonomike - aktvendimi i prishur - ankesa e refuzuar - juridiksioni absolut i Gjykatës neni 354(2) pika 3 / neni 16 (2) LPK - neni 14 LPP]

Kreditori NSHIMB "Kualiteti" paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë.

Kreditori me propozim për ekzekutimin e aktvendimit kërkon nga debitori të paguajë borxhin. Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë refuzoi propozimin e kreditorit për të lejuar ekzekutimin e aktvendimit kundër debitorit Posti Ushtarak i Armatës Jugosllave në Leskovc.

Gjykata Supreme ka vendosur se aktvendimi i Gjykatës është në kundërshtim me dispozitat në fuqi të procedurës kontestimore siç parashihet me nenin 354 (2), pika 3 në lidhje me nenin 16 (2) të LPK-së dhe nenin 14 LPP. Gjykata Supreme ka vendosur se shkelja e procedurës kontestimore si e tillë buron nga faktet se propozimi për të lejuar ekzekutimin e aktvendimit kundër debitorit nuk bie as në kuadër të juridiksionit të Gjykatave të rregullta të Kosovës dhe as të ndonjë Gjykate tjetër me kompetencë të posaçme duke konsideruar se debitori nuk kishte as zyre përfaqësuese dhe as selinë e vet në territorin e Kosovës siç parashikohet me nenin 55 të Ligjit për Zgjidhjen e Konfliktëve me Jurisdikcionin e Huaj. Gjykata Supreme ka vendosur se nëse gjatë procedurës për zgjidhjen e konfliktit asnjë Gjykatë e themeluar me ligj nuk është kompetente, atëherë Gjykata hedh poshtë kërkesëpadinë siç parashihet me nenin 16(2) të LPK-së.

Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e kreditorit është e pabazë dhe prishi aktvendimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut dhe hodhi poshtë kërkesëpadinë.

Ae.nr.31/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Meleqe Behxheti, kryetare, Shahdane Agani, Osman Tmava, anëtarë, në kontestin e kreditorit NSHIMB "Kualiteti" në Gjilan, kundër debitorit AJ Posta Ushtarake 8624 Ferizaj, për borxh në vlerë prej 104.285,10 dinarë, sipas ankesës së kreditorit paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut Prishtinë, E.nr.60/2004 datë 21.04.2005, në seancën e mbajtur më 25.05.2005, mori këtë:

A K T V E N D I M

Prishtet aktvendimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut Prishtinë, E.nr.60/2004 datë 21.04.2005, hidhet poshtë padia.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut Prishtinë E.nr.60/2004 datë 21.04.2005, është refuzuar propozimi i kreditorit për lejimin e përbarimit kundër debitorit AJ Posta Ushtarake 8624 në Ferizaj.

Kundër këtij aktvendimi kreditori me kohë ka paraqitur ankesë me propozim që aktvendimi i goditur të prishet dhe lënda t'i kthehet Gjykatës së Shkallës së Parë për rigjykim.

Pas shqyrtimit të aktvendimit të goditur sipas nenit 365 par.2 lidhur me nenin 381 dhe 369 par.2 të LPK, Gjykata Supreme e prishi aktvendimin dhe e hodhi poshtë padinë.

Nga shkresat e lëndës del se kreditori me propozim për përbarim kërkon që debitori të detyrohet që atij në emër të borxhit të paguajë shumën prej 104.285,10 dinarë.

Gjykata e Shkallës së Parë ka gjetur se debitori AJ Posta Ushtarake 8624 në Ferizaj sipas nenit 21 të Ligjit të Procedurës Përbaruese (LPP), nuk është person juridik që ushtron veprimtarinë ekonomike, prandaj ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se aktvendimi i goditur është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore parashikuar nga neni 354 par.2 pika 3 lidhur me nenin 16 par.2 të LPK dhe nenin 14 të Ligjit të Procedurës Përbaruese (LPP), për të cilën kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare. Shkelje e tillë e procedurës kontestimore është e natyrës absolute për shkak të së cilës doemos duhet të prishet aktvendimi i goditur dhe të hidhet poshtë padia. Shkelja e tillë e procedurës kontestimore qëndron në faktet se propozimi për lejimin e ekzekutimit kundër debitorit AJ Posta Ushtarake 8624 në Ferizaj nuk është në kompetencë të Gjykatave të rregullta të Kosovës e as në kompetencë të asnjë Gjykate të veçantë.

Ligji i Procedurës Kontestimore ka parashikuar se Gjykata gjatë tërë procedurës kujdeset sipas detyrës zyrtare se a është zgjidhja e kontestit në kompetencë gjyqësore. Kur Gjykata gjatë procedurës konstaton se për zgjidhjen e kontestit nuk është kompetente asnjë Gjykatë e themeluar me ligj do ta hedhë padinë (neni 16 par.2 të LPK).

Me nenin 14 të Ligjit të Procedurës Përbaruese parashikohet se në procedurën e përbarimit dhe të sigurimit zbatohen analogjikisht dispozitat e Ligjit të Procedurës Kontestimore, nëse me këtë ligj ose me dispozita të tjera federative nuk është përcaktuar ndryshe.

Me nenin 46 par.1 dhe 2 të Ligjit për Zgjidhjen e Konfliktit të ligjeve me dispozitat e vendeve të tjera në marrëdhënie të caktuara parashikohet se ekziston kompetenca e RSFJ, nëse i padituri ka vendbanim, përkatësisht selinë, në RSFJ. Nëse i padituri nuk e ka vendbanimin në RSFJ dhe as në ndonjë shtet tjetër, kompetenca e Gjykatës së RSFJ ekziston kur i padituri është me vendqëndrim në RSFJ.

Me nenin 55 të Ligjit për Zgjidhjen e Konfliktit të ligjeve me dispozitat e vendeve të tjera në marrëdhënie të caktuara parashikohet se në kontestet kundër personit fizik apo personit juridik që ka selinë në botën e jashtme, për detyrimet që kanë lindur në RSFJ ose të cilat duhet të kryhen në territorin e RSFJ, ekziston kompetenca e Gjykatës së RSFJ nëse ky person ka në territorin e RSFJ përfaqësinë e vet ose kur në RSFJ ndodhet selia e organizatës së punës së bashkuar, së cilës i është besuar ushtrimi i punëve të tij. Në rastin konkret debitori nuk e ka as përfaqësinë e as selinë në territorin e Kosovës.

Kompetenca absolute - juridiksioni i Gjykatës është prezumimi themelor procedural për dhënien e mbrojtjes gjyqësore. Rrethana që për zgjidhjen e çështjes konkrete juridike nuk është kompetente asnjë Gjykatë e rregullt e as ndonjë Gjykatë tjetër e veçantë në Kosovë, del se aktvendimi është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe dispozitave të procedurës përbaruese, e cila si pasojë ka prishjen e aktvendimit.

Në bazë të asaj që u tha e me zbatimin e nenit 369 par.2 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË
Ae.nr.31/2005, datë 25.05.2005

Kryetare e kolegjit,
Meleqe Behxheti

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi kontestet ekonomike -aktvendimi i prishur - ankesa e refuzuar - jurisdikcioni absolut i Gjykatës - neni 354 (2) pika 3 / neni 16 (2) LPK - neni 14 LPP]

Kreditori NSHIMB "Kualiteti" paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë.

Kreditori me propozim për ekzekutimin e aktvendimit kërkon nga debitori të paguajë borxhin. Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë refuzoi propozimin e kreditorit për të lejuar ekzekutimin e aktvendimit kundër debitorit Posti Ushtarak i Armatës Jugosllave në Leskovc.

Gjykata Supreme ka vendosur se aktvendimi i Gjykatës është në kundërshtim me dispozitat në fuqi të procedurës kontestimore siç parashihet me nenin 354 (2), pika 3 në lidhje me nenin 16 (2) të LPK-së dhe nenin 14 LPP. Gjykata Supreme gjeti se shkelja e procedurës kontestimore si e tillë buron nga faktet se propozimi për të lejuar ekzekutimin e aktvendimit kundër debitorit nuk bie as në kuadër të jurisdikcionit të Gjykatave të rregullta të Kosovës dhe as të ndonjë Gjykate tjetër me kompetencë të posaçme duke konsideruar se debitori nuk kishte as zyre përfaqësuese dhe as selinë e vet në territorin e Kosovës siç parashikohet me nenin 55 të Ligjit për Zgjidhjen e Konfliktëve me Jurisdikcionin e Huaj. Gjykata Supreme gjeti se nëse gjatë procedurës për zgjidhjen e konfliktit asnjë Gjykatë e themeluar me ligj nuk është kompetente, atëherë Gjykata hedh poshtë kërkesëpadinë siç parashihet me nenin 16(2) të LPK-së.

Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e kreditorit është e pabazë dhe prishi aktvendimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut dhe hodhi poshtë kërkesëpadinë.

Ae.nr.33/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji për konteste ekonomike i përbërë nga gjyqtarët: Shahdane Agani, kryetare, Meleqe Behxheti, Osman Tmava, anëtarë, në kontestin e kreditorit NSHIMB "Kualiteti" në Gjilan, kundër debitorit AJ Posta Ushtarake 4466/12 Ferizaj, për borxh në vlerë prej 71.953,60 dinarë, sipas ankesës së kreditorit paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut Prishtinë, E.nr.61/2004 datë 21.04.2005, në seancën e mbajtur më 25.05.2005, mori këtë:

A K T V E N D I M

Prishtet aktvendimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut Prishtinë, E.nr.61/2004 datë 21.04.2005, hidhet poshtë padia.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut Prishtinë E.nr.61/2004 datë 21.04.2005, është refuzuar propozimi i kreditorit për lejimin e përmbarimit kundër debitorit AJ Posta Ushtarake 4466/12 në Ferizaj.

Kundër këtij aktvendimi kreditori me kohë ka paraqitur ankesë me propozim që aktvendimi i goditur të prishet dhe lënda t'i kthehet Gjykatës së Shkallës së Parë për rigjykim.

Pas shqyrtimit të aktvendimit të goditur sipas neni 365 par.2 lidhur me nenin 381 dhe 369 par.2 të LPK, Gjykata Supreme e prishi aktvendimin dhe e hodhi poshtë padinë.

Nga shkresat e lëndës del se kreditori me propozim për përmbarim kërkon që debitori të detyrohet që atij në emër të borxhit të paguajë shumën prej 71.953,60 dinarë.

Gjykata e Shkallës së Parë ka gjetur se debitori AJ Posta Ushtarake 4466/12 në Ferizaj sipas neni 21 të Ligjit të Procedurës Përmbaruese (LPP), nuk është person juridik që ushtron veprimtarinë ekonomike, prandaj ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se aktvendimi i goditur është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore parashikuar nga neni 354 par.2 pika 3 lidhur me nenin 16 par.2 të LPK dhe nenin 14 të Ligjit të Procedurës Përmbaruese (LPP), për të cilën kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare. Shkelje e tillë e procedurës kontestimore është e natyrës absolute për shkak të së cilës doemos duhet të prishet aktvendimi i goditur dhe të hidhet poshtë padia. Shkelja e tillë e procedurës kontestimore qëndron në faktet se propozimi për lejimin e ekzekutimit kundër debitorit AJ Posta Ushtarake 4466/12 në Ferizaj nuk është në kompetencë të Gjykatave të rregullta të Kosovës e as në kompetencë të asnjë Gjykate të veçantë.

Ligji i Procedurës Kontestimore ka parashikuar se gjykata gjatë tërë procedurës kujdeset sipas detyrës zyrtare se a është zgjidhja e kontestit në kompetencë gjyqësore. Kur Gjykata gjatë procedurës konstaton se për zgjidhjen e kontestit nuk është kompetente asnjë Gjykatë e themeluar me ligj

do ta hedhë padinë (neni 16 par.2 të LPK).

Me nenin 14 të Ligjit të Procedurës Përmbarese parashikohet se në procedurën e përbarimit dhe të sigurimit zbatohen analogjikisht dispozitat e Ligjit të Procedurës Kontestimore, nëse me këtë ligj ose me dispozita të tjera federative nuk është përcaktuar ndryshe.

Me nenin 46 par.1 dhe 2 të Ligjit për Zgjidhjen e Konfliktit të ligjeve me dispozitat e vendeve të tjera në marrëdhënie të caktuara parashikohet se ekziston kompetenca e RSFJ, nëse i padituri ka vendbanim, përkatësisht selinë, në RSFJ. Nëse i padituri nuk e ka vendbanimin në RSFJ dhe as në ndonjë shtet tjetër, kompetenca e Gjykatës së RSFJ ekziston kur i padituri është me vendqëndrim në RSFJ.

Me nenin 55 të Ligjit për Zgjidhjen e Konfliktit të ligjeve me dispozitat e vendeve të tjera në marrëdhënie të caktuara parashikohet se në kontestet kundër personit fizik apo personit juridik që ka selinë në botën e jashtme, për detyrimet që kanë lindur në RSFJ ose të cilat duhet të kryhen në territorin e RSFJ, ekziston kompetenca e Gjykatës së RSFJ nëse ky person ka në territorin e RSFJ përfaqësinë e vet ose kur në RSFJ ndodhet selia e organizatës së punës së bashkuar, së cilës i është besuar ushtrimi i punëve të tij. Në rastin konkret debitori nuk e ka as përfaqësinë e as selinë në territorin e Kosovës.

Kompetenca absolute - juridiksioni i Gjykatës është prezumimi themelor procedural për dhënien e mbrojtjes gjyqësore. Rrethana që për zgjidhjen e çështjes konkrete juridike nuk është kompetente asnjë Gjykatë e rregullt e as ndonjë Gjykatë tjetër e veçantë në Kosovë, del se aktvendimi është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe dispozitave të procedurës përmbarese, e cila si pasojë ka prishjen e aktvendimit.

Në bazë të asaj që u tha e me zbatimin e nenit 369 par.2 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË
Ae.nr.33/2005, datë 25.05.2005

Kryetare e kolegjit,
Shahdane Agani

344 bosh